

STATUTI
I
SHOQERISE
"SBS Small Business Service"sh.p.k.

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Ne Durres, sot me date 16.01.2018, me ane te ketij dokumenti te hartuar ne 2 (dy) kopje origjinale, une :

ORTAKU I VETEM THEMELUES : **Giovanni Clemente**, mbajtës i Pasaportes nr. AA3281794, e vlefshme deri më 07.08.2018, shtetas italian, lindur më 13.11.1958 në Pordenone dhe banues ne Shqiperi,

Hartoj statutin e shoqerise "**SBS Small Business Service**" sh.p.k.

Neni 2

Shoqeria "**SBS Small Business Service**" sh.p.k. është person juridik i se drejtes shqiptare, e organizuar ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe si e tille do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe ne perputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit te shoqërisë është caktuar deri më 31.12.2050.

Neni 4

Shoqëria ka si objekt te veprimtarisë se saj:

- Shoqeria SBS ka per objekt te saj ofrimin e sherbimeve per kompanite, shqiptare dhe te huaja, si: sherbimin e hedhjes se te dhenave ne sistem, sherbim te back office, sherbime administrative, sherbim te rekuperimit te kredive, perfshire sherbimin e kerkeses per pagese nepermjet telefonit, sherbimin e call – center dhe telemarketing dhe gjithcka tjeter te nevojshme per kryerjen e aktiviteteve ne fjale.
- Shoqeria mund te ushtroje te gjitha aktivitetet e tjera tregtare, industriale dhe financiare, operimin me pasuri te tundshme dhe te patundshme qe nga organet administrative do te konsiderohen si aktivite operative shtese, te lidhura, te domosdoshme apo te dobishme per realizimin e aktivitetit qe perbejne objektin social te shoqerise, te kerkoje interesa apo te ndermarre pjesmarrje ne shoqeri apo ndermarrje te tjera qe kane si objekt aktivite analoge, te peraferta, te lidhura me te sajat, si ne menyre direkte ashtu dhe indirekte, si ne Shqiperi ashtu dhe jashte shtetit. Gjithashtu shoqeria mund te jape garanci dhe te ofroj dorezani ne favor te te treteve, edhe pa pagese, e gjitha kjo per sa kohe keto aktivite te mos kryhen ne ngarkim te publikut dhe masa e ushtrimit te tyre te mos jete mbizotruese ne raport me ato aktivite qe perbejne qellimin social.

Neni 5

Selia e shoqërisë është në adresën: Lagjja nr. 3, Rruga Migjeni, Zona Kadastrale 8514, Nr. Pasurie 3/517/ND-N8, Vol.36, Fq.126. Asambleja ka kompetencën të hapë dëgje dhe zyra përfaqësimi të tjera dhe t'i mbyllë ato nëse e quan të nevojshme.

KREU II **KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTA** **Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbehet vetëm nga kontribute në para dhe është 100 (njëqind) Lekë. Ky kapital është i nënshkruar dhe i paguar e është i ndarë në 1 (një) kuota me vlerë nominative 100 (njëqind) Lekë.

Kuota zotërohet në masën 100% nga ortakët i vetëm i shoqërisë Giovanni Clemente.

Ortakët me kërkesë të Administratorit dhe në përputhje me dispozitat në fuqi të karakterit fiskal, ka të drejtë të kryej pagesa apo të japë kontribute, në kapital, ose financime në favor të shoqërisë, të cilat konsiderohen financime pa interes. Shuma e financuar, afati i kthimit dhe mënyra e rimbursimit të tyre rregullohen me kontratën përkatëse. Shumat e mësipërme mund të përdoren për të mbuluar humbjet ose transferohen direkt në rritjen e kapitalit në përputhje me vendimin e asamblesë së ortakëve.

KREU III **TRANSFERIMI I PJESEVE NOMINATIVE TE KAPITALIT THEMELTAR** **Neni 7**

Kuota që përben kapitalin e shoqërisë është lirish e transferueshme, midis të tjerëve dhe bashkëshortëve në rastin e ndarjes së pasurisë në bashkëpronësi familjare dhe trashëgimtareve në rast vdekje.

KREU IV **ASAMBLEJA** **Neni 8**

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimor i shoqërisë.

Vendimet e saj merren në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë Statut dhe janë të detyrueshme. Ato protokollohen në regjistër të veçantë në përputhje me ligjin.

Asambleja ka të drejtë të ushtrojë në çdo moment verifikime mbi Administratorin/et dhe të kontrollojë çdo dokument të shoqërisë. Ajo mund të urdhërojë apo të udhëzojë administratorin/et në kryerjen e detyrës së tij.

Asambleja ka këto kompetenca:

- Vendos për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe strategjive të zhvillimit, përfshirë edhe investimet kapitale;
- Vendos për ndryshimet e statutit;
- Emëron dhe shkarkon Administratorin/et, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të Miratuar, si dhe përcakton shpërblimet e tyre;
- Vendos për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Vendos për pjesëtimin e kuotave dhe/ose anulimin e tyre;
- Vendos për transferimin (blerjen, shitjen dhurimin, shkëmbimin) e pasurive të shoqërisë, për cedimin apo për dhenien me qira të shoqërisë ose degeve të saj, për dhenien me qira të asetëve të shoqërisë;
- Vendos për miratimin e huamarrjeve me interes nga të tjerët;
- Vendos për dhenien e garancive hipotekore, pengut, barreve sigurorese, dorezanise etj;

- Miraton Bilancet, pasqyrat financiare dhe raportet e eksperteve kontabel te miratuar;
- Miraton shperdarjen e fitimit, nepermjet ndarjes se dividenteve ose vendos per kapitalizimin e tyre nepermjet zmadhimit te kapitalit;
- Miraton strukturen organizative te shoqerise, rregulloren e brendeshme dhe organogramen, rregulloren e sigurimit teknik, si dhe politikat dhe nivelin e pagave dhe shperblimeve per cdo vend pune ne shoqeri;

Neni 9 **Menyra e Thirrjes se Asamblese**

Asambleja thirret nga Administratori/et ose nga ortaku i vetem i shoqerise, nËpËrmjet nËj njoftimi me shkrim.

Njoftimi me shkrim duhet tË pËrmbajË vendin, datËn, orËn e mbledhjes dhe rendin e ditËs dhe duhet t'i dËrgehËt tË gjithË subjekteve te interesuar, jo mË vonË se 7 ditË pËrpara datËs sË parashikuar pËr mbledhjen e AsamblesË.

MegjithatË janË te vlefshme edhe mbledhjet e AsamblesË qe nuk janË thirrur si me sipËr, nËse ËshtË i pËrfaqËsuar i gjithË kapitali dhe nese ne mbledhje asiston Administratori/et dhe eksperti kontabël i miratuar (nËse ben pjese ne strukturen se shoqerise).

Ne Asamble duhet te marrin pjese te gjithË ata qe figurojnË te regjistruar ne librin e ortakeve.

Ortaku ka te drejtËn e votËs ne Asamble ne proporcion me kuotËn qe zotËron ne kapitalin e shoqËrisË.

Ortaku mund te pËrfaqËsohet vete, ose nËpËrmjet nËj personi te pajisur me prokure, i cili nuk duhet te jete administrator, apo ekspert kontabël i autorizuar ose vartËs i vete shoqËrisË apo ndonjË shoqËrie tjetËr te kontrolluar prej saj. I takon Administratorit/ve te verifikojte te drejtËn e pjesËmarrjes pËr ortakun.

Ortaku nuk mund tË ushtrojË tË drejtËn e votËs nËse Asambleja e pËrgjithshme merr vendim pËr vlerËsimin e veprimtarisË sË tij, shuarjen e ndonjË detyrimi nË ngarkim tË tij, ngritjen e nËj padie ndaj tij nga shoqËria, dhËnien ose jo tË pËrfitimeve tË reja.

Asambleja drejtohet nga Administratori/et dhe ne mungese te tij/tyre, pjesËmarrËsit ne mbledhje, me shumice absolute te kapitalit prezent ne salle, zgjedhin nËj drejtues.

Asambleja emËron nËj sekretar edhe jashte bashkesise se ortakeve. Sekretari mban P/verbalin e mbledhjes i cili duhet te permbaje:

- a) daten kur eshte marre vendimi;
- b) identitetin e votuesve dhe kapitalin qe ata perfaqesojne;
- c) identifikimin e ortakeve pro, abstenues ose kundra;
- d) sipas kerkeses se ortakeve deklarimet e tyre mbi vendimin e marre;

Vendimi i AsamblesË duhet te nËnshkruhet ortaku i vetem i shoqerise prezent ne mbledhje dhe ne munges te tij nga personi i autorizuar nga vete ai, si dhe nga sekretari. Kur e parashikon ligji, apo kur administratori e sheh te arsyeshme, P/Verbali i mbledhjes mbahet nga nËj noter i zgjedhur prej tij.

Neni 10 **Kuorumi dhe Vendimarrja**

Vendimet e AsamblesË qe merren me shumice te zakonshme, jane te gjitha vendimet e Asamblese per te cilat Ligji dhe Statuti nuk kerkojne nje shumice te cilesuar.

Vendimet qe merren me shumice te zakonshme jane te vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortaket (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se 30 pËr qind tË kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me shumicen e votave te ortakeve pjesemarrës. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar, Asambleja mblidhet pËrsËri jo mË vonË se 30 ditË, me tË nËjtin rend dite.

Per Vendimet e AsamblesË qe merren me shumice te cilesuar, mbledhja eshte e vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortaket (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese

është vendosur me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakeve pjesëmarrës. Në rast se nuk arrihet Kuorumi i përcaktuar më sipër, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Merren me shumicë të cilesuar këto vendime:

- Ndryshimi i Statutit;
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- Riorganizimi (shendrimi, bashkimi, ndarja) si dhe/ose prishja e shoqërisë,
- Shpërndarja e fitimeve ose kapitalizimi i tyre;
- Përcaktimi i politikës dhe masës së pagave dhe shpërblimeve për çdo pozicion pune në shoqëri, duke përfshirë edhe përcaktimin e pages apo shpërblimit të Administratorit, ekspertit kontabel të miratuar dhe likuiduesve;

Asambleja e Përgjithshme me nismën e saj ose me kërkesën e ortakeve që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar, mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Neni 11 **Zmadhimi i kapitalit themeltar**

Vendoset nga Asambleja sipas prashikimit të bërë në pikën 3 të Nenit 10 të këtij Statuti. Pas vendimit të asamblesë për zmadhimin e kapitalit, ortakët i vetëm të shoqërisë mund të kryejnë zmadhimin e kapitalit në para dhe në natyrë. Në rastin e zmadhimit në para brenda 30 ditëve duhet të bëjnë derdhjet respektive.

Administratori/et duke u mbështetur në ligj dhe pa autorizim paraprak të Asamblesë, mund t'i kërkojnë llogari ortakës se vetme që ka nënshkruar zmadhimin e kapitalit, për derdhjen e kontributeve brenda afatit të sipërpërmendur.

Neni 12 **Zvogëlimi i kapitalit**

Vendoset nga Asambleja sipas prashikimit të bërë në pikën 3 të Nenit 10 të këtij Statuti.

Kur vendimi i zvogëlimin të kapitalit nuk motivohet nga humbjet në aktive, kreditorët e shoqërisë duhen njoftuar menjëherë.

Ata mund të kundërshtojnë vendimin pranë organeve gjyqësore.

Neni 13 **Transformimi**

Shndërrimi i shoqërisë në shoqëri aksionere, bëhet mbas hartimit të raportit përkatës nga Administratori/et dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme, Vendoset nga Asambleja sipas prashikimit të bërë në pikën 3 të Nenit 10 të këtij Statuti, si dhe në përputhje me nenet 228 dhe 229 të Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare". Është i pavlefshëm çdo transformim i shoqërisë në kundërshtim me këtë dispozitë.

ADMINISTRIMI **Neni 14**

Administrimi dhe përfaqësimi i shoqërisë i besohet **Z. Giovanni Clemente**, lindur më 13.11.1958 në Pordenone Itali dhe banues në Shqipëri, mbajtës i Pasaportës nr. AA3281794.

Administratori është emëruar për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rimerimi, me përjashtim në rastet e dorëheqjes apo shkarkimit nga ana e Asamblesë.

Administratori gëzon kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektivit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që Statuti ia njeh Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori ka të drejtën dhe detyrimin që:

- Te kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- Te zbatojë politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e përgjithshme;
- Te përfaqësojë shoqërinë tregtare përpara të tjerëve;
- Te kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Te përgatise dhe të nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë;
- Te përgatise buxhetin vjetor të shoqërisë.
- Te përgatise propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe t'i paraqesë këto dokumente përpara Asamblesë për miratim;
- Te krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Te kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Te raportojë përpara Asamblesë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Te propozojë dhe t'i paraqesë Asamblesë për miratim strukturën organizative të shoqërisë, rregulloren e brendshme, organogramin dhe rregulloren e sigurimit teknik;
- Te mos kryejë veprimtari konkurruese (ndalimi i konkurrencës) me veprimtari që kryen shoqëria.
- Administratori ka të drejtën të rimbursohet për shpenzimet e bera për arsye pune si dhe të drejtën e një rroge mujore të aprovuar nga Asambleja.

Administratori kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut. Ai mund të vete në lëvizje instanca juridike dhe administrative, duke emëruar avokate e duke lëshuar prokurë në rastet e gjyqesh, duke kryer operacione bankare, këtu përfshirë edhe hapjen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse, nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e tërheqjeve dhe derdhjeve me leke në dorë apo urdhër xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Viti ekonomik fillon me 01 Janar deri me 31 Dhjetor çdo viti.

Neni 15

Administratori/et mund të emërojnë përfaqësues, të cilëve, individualisht apo kolektivisht, mund t'u japin të drejtën e firmës, si dhe ato kompetenca, shpërblime e garanci që do të vlerësojnë të arsyeshme. Ata mundet gjithashtu të emërojnë drejtues ose përfaqësues për akte apo kategori aktesh të caktuar.

Neni 16

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori/et është përgjegjës individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose të tjerëve për shkeljet ligjore të Statutit apo fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.



Shoqëria nuk është përgjegjëse ndaj te tretëve, për aktivitete te kryera nga Administratori/et ne kundërshtim me kompetencat e tyre, kur vërteton se ata (te tretet) ishin ne dijeni te kësaj rrethane.

Neni 17

Asambleja e përgjithshme mund ti shkarkojë Administratorit/et në çdo kohë me shumicë të zakonshme, duke dhene nje motivacion. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 18

PERFAQESIMI I PUNEMARRESVE

Nëse shoqëria ka me shume se 50 punonjës atëherë ata kane te drejtën te organizojnë një Këshill te punëmarrësve me një mandat 5-vjeçar me te drejte ripërtëritje ose kur shoqëria ka te punësuar me shume se 20 punëmarrës po me pak se 50 atëherë për çdo 10 punëmarrës zgjidhet një përfaqësues. Këshilli i Punëmarrësve apo përfaqësuesit e tyre gëzojnë te gjitha te drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga neni 20 i Ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 19

EKSPERTI KONTABEL I MIRATUAR

Emërimi i ekspertit kontabël te miratuar behet me vendim te Asamblesë, e cila përcakton mandatin dhe shpërblimin.

Kur ligji e parashikon shprehimisht prezencën e ekspertit kontabël te miratuar, janë te pavlefshme operacionet e kryera pa prezencën e tij.

Neni 20

Eksperti Kontabël i miratuar pasi ka verifikuar librat kontabël, arkën dhe depozitat bankare, garanton qe kontabiliteti vjetor është mbajtur ne rregull, i korrespondon te vërtetës dhe është ne përputhje me legjislacionit ne fuqi.

Mund te shkarkohet nga funksionet e tij me vendim te Asamblesë si dhe me vendim gjykate.

Eksperti Kontabël i miratuar përpilon dhe i paraqet Asamblesë një raport financiar mbi ushtrimin vjetor qe pasqyron situatën financiare ne nisje dhe atë ne mbyllje.

Kontrollon qe bilanci përfundimtar dhe Raporti i përpiluar nga Administratoret për Asamblenë, t'i korrespondoje realitetit.

Është i detyruar ti paraqesë Administratoreve dhe Asamblesë se ortakeve:

a) Kontrollet, verifikimet dhe sondazhet e bëra;
b) Zërat e bilancit dhe dokumentacionin kontabël qe duhet korrigjuar duke sygjerruar edhe zgjidhjet;

c) Gabimet dhe pasaktësitë e konstatuara;

d) Rezultatin financiar pas korrigjimeve te bëra;

Ai duhet te thirret ne te gjitha mbledhjet e Asamblesë se ortakeve ku aprovohet bilanci i aktivitetit gjithë vjetor, por mund te thirret ne te gjitha rastet kur konsiderohet e nevojshme.

Neni 21

Eksperti kontabël i miratuar përgjigjet ndaj shoqërisë dhe ndaj te tretëve për pasojat e negative qe rrjedhin nga gabime e neglizhime ne kryerjen e funksionit te tij.

Nuk mban përgjegjësi për shkeljet ligjore te kryera nga Administratoret, me përjashtim te rasteve kur ka pasur dijeni për to, por nuk ia ka paraqitur dhe raportuar Asamblesë.

KREU V

FITIMI DHE FONDET

Neni 22

Fitimi qe do te shpërndahet përbehet nga fitimet e realizuar gjate vitit financiar te sapo mbyllur.

Asambleja mund te vendose për formimin e fondeve te ndryshme dhe shpërndarjen e tyre.

Neni 23

Asambleja pasi ka miratuar bilancin përfundimtar dhe ka vendosur shumën qe do te shpërndahet, përcakton pjesën e fitimit për secilin ortak ne raport me kuotën qe zotëron secili.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse Administratori, nen përgjegjësinë e tij personale, lëshon një certifikatë të aftësisë pagese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat nenit 77 te Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare"

Dividendët qe nuk korrespondojnë me fitimet e realizuara realisht, mund t'u reklamohen ortakëve qe i kane marre ato.

KREU VI

PAVLEFSHMERIA, PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 24

Statuti si dhe aktet e tjera te shoqërisë mund te konsiderohen te pavlefshëm, vetëm ne rast se shkelen dispozitat e parashikuara nga Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ose nga Kodi Civil.

Neni 25

Shoqëria mund te prishet vetem ne keto raste:

- me vendim të Asamblesë së përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- me vendim të gjykatës.

Neni 26

LIKUIDIMI

Kur me vendim gjykate shpallet pavlefshmëria absolute apo relative e shoqërisë si dhe ne rastet e parashikuara ne statut, asambleja e përgjithshme vendos prishjen e parakohshme te shoqërisë dhe fillojnë procedurat e likuidimit qe do te kryhen sipas kërkesave te parashikuara ne Ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ne përgjithësi nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

ORTAKU I SHOQERISE

"SBS Small Business Service"sh.p.k.

GIJOPHIL CEMENTE
